

The “Raven” by Isuf Luzaj as a model of his philosophical poetry

Abstract: *The following study centres around and analyses the poem “The Raven” by I. Luzaj. In fact, the poem appears to represent this author’s model of philosophical poetry. By analysing its iconography, rhythm and metric, along with syntax, grammar, semantics, typology, symbols, archetypes and themes, author Hysa tries to dissemble the literary means used by the poet-philosopher when interweaving abstract ideas with poetic form.*

Keywords: *Philosophical Poetry, Isuf Luzaj, Raven, Farewell of the stars, analyses, Albanian poetry.*

Lidhja e filozofisë dhe poezisë është një karakteristikë e brendshme të krijimtarisë poetike të Isuf Luzajt. Po a i ka dhënë vlerë poezisë mendimi abstrakt i Luzajt filozof apo e ka dëmtuar? Poezia e Isuf Luzajt duhet trajtuar si një filozofi e vargëzuar apo poezi që mbart dhe trajton tema filozofikë në mënyrë organike? Mos ndoshta në përcaktimin e poezisë së Luzajt si poezi filozofike kushtëzohemi nga të dhënat biografike të autorit, duke na paravendosur kështu në një qëndrim të gabuar kritik ndaj veprës së tij? Kultura dhe formimi i Luzajt si filozof nuk mundet njëkohësisht të përshitet, por është e nevojshme të përcaktohet deri në ç’masë ka ndikuar ky formim në ligjërimin poetik.

Për të analizuar sa poet dhe sa filozof është Luzaj në krijimtari do të na ndihmonte interpretimi i një prej poezive të tij më të mira: **Korbi**, tek *Lamtumira e Yjeve*:

*Dezertojnë flokët e kokës pa u dukur,
e kuptuan që po ikën Nëntori.
Dridhen shpresat e lodhura duke u strukur
Në ndonjë tempull “Refugium peccatori”,
bjenë iluzionet aty më të mugur
si fletë ulliri kur zhvishet i gjori.
Vaniteti kërkon mermer të pabesë,
kusar i Moralit, Etikës dhe Fesë,
me të gjitha hiperbolat të eulogjisë gënjeshtare,*

*sillet për qark melankolia syzezë
si mizë fluturake etuar në qilare,
bezdis plakun që i ka ngrirë dora.*

*Esenca atavike që lodhi ekzistenca
Venitur si antulja, mbuluar nga bora,
dëshpëruar që s'i mbaroi qëllimet.
Shumë e shkurtër jeta për t'i përmbushur
Premtimet. Aq i egër, i fortë realiteti
Fluturon e çmendur koha tamahqare,
sa të hapësh e të mbyllësh sytë u mbyt
në valë deti.
Struktura e arkitektit, kështjellë ideale.
Ëndërr qe, ëndërr jetoi, ëndërr mbeti,
përpyekja heroike, fisnike vigane.
Dorëzohet më në fund Ekzistenca,
Fik çirakun dhe bje për të fjetur.
Atë që kërkoi, kurrë s'e pat gjetur
Në udhëtimin që e spërkati me lot me lemza.*

Poezia mban titullin **“Korbi”** në përjasje të Korbit të Poe-së, poetit të adhuruar të Luzajt. Sipas tekstit biblik, korbi është shpendi që dikur ka qenë pëllumb, por është dënuar përjetë që të ketë ngjyrën e zezë, si dhe të mos zbresë në tokë. Hija e Korbit mistik e të frikshëm të Poe-së, simbol të fajit pezullak e të pakohë që përjetohet si makth, ka ushqyer gjatë fantazinë e poetëve. Një poezi me po të njëjtin titull ka shkruar dhe Martin Camaj. Po ndërsa poezia e Poe-së dhe ajo e Camajt e ruajnë Korbin si protagonist, tek Luzaj shpendi nuk përmendet në poezi, por qëndron në krye-titull si shpatë, hije e zezë e vdekjes dhe si shenjë e dënimit të përjetshëm të poetit me harrimin.

Ideja filozofike e *Ankthit të njeriut para vdekjes dhe pamundësisë së tij për të realizuar veten brenda një harku kohor të shkurtër, e frikës premordiale ndaj harrimit dhe pamundësisë për të përqaftuar pavdekësinë¹*, përçohet tek lexuesi nëpërmjet tekstit poetik. Për të kuptuar sesa është

1 Ideja filozofike e poezisë shpjegohet sipas konceptit të Kirkegardit, në të cilën njehtësohet edhe koncepti i Luzaj: “Në jetën e njeriut – shprehet Kierkegaardi - ka një lëvizje nga gjendja esenciale në atë ekzistencialenjë lëvizje nga esenca në ekzistencë. Shpjegimi tradicional i kësaj lëvizje në teologji bëhet në lidhje me doktrinën e mëkatit, **të Rënies**. Kirkegardi e shndërron këtë doktrinë në një analizë të thellë psikologjike, ku ai veçoi ankthin e njeriut për fundin e tij si shkak të shkëputjes ose tjetërsimit të tij nga qenia e tij esenciale. Natyra esenciale e njeriut kërkon lidhjen me Zotin e tij, pafundësinë”. Shiko: Samuel Enoch Stumpf, *Filozofia, Historia & Problemet*, Toena, Tiranë, fq. 447.

arritur estetikisht kjo shkrirje do të na ndihmonte një analizë e poezisë në nivel konotativ, zbërthyer në disa nënnivele të shprehësisë së formës dhe përmbajtjes². Analiza do të na ndihmojë për të kuptuar se sa dhe se si ideja filozofike e mësipërme shtresohet në një tekst poetik. Kështu kemi:

1. Në nivel **ikonorafik**, që ka të bëjë me paraqitjen vizive dhe me organizimin hapësinor-tipografik të tekstit, do të vërenim se autori shkruan me shkronja të mëdha pikërisht sintagmën: **“REFUGIUM PECCATORUM”**, duke dashur të theksojë si tabele orientuese vendim prehës dhe “qelën” kirkegardiane të njeriut, fjalët kyç: **Esenca/Ekzistenca** janë shkruar me shkronjë të madhe, po kështu edhe fjalët: **Moralit, Etikës, Fesë**, të cilat emërtojnë dhe fazat në të cilat kalon njeriu për të shkuar në Përjetësi.

2. Në nivel **ritmik e metrik** – nëpërmjet **rimës** foljore: **dukur/strukur**; kombinuar me mbiemër: **të muguar**; rimim i realizuar me rrokjen “kur” e cila mbyllet me zanoren “u” në mes, për të dhënë idenë e etapës së parë estetike të ekzistencës njerëzore³, e cila përbën në të shumtën e rasteve dhe një fazë të pakapërcyeshme, ndaj dhe varjet e parafundit ruajnë të njëjtën rimë: **fjetur/gjetur**; nëpërmjet rimës emërore: **Nëntori/Pecatori/**; kombinuar me mbiemër: **i gjori**; e cila nëpërmjet zanores “i” në fund jep një spirale kalimi nga rima me zanore të mbyllur tek ajo me zanoren ndërmjetëse, si për të kërkuar kalimin në fazën e dytë, etike, të njeriut; **të pabesë/Fesë/syzezë; gënjeshtare/qilare; dora/bora**. rimë që shkon drejt rrokjes së hapur “a”, ndërsa përmbyllja e rimës i takon fjalës **Ekzistenca/lemza**, duke shprehur kundërshtinë mes dëshirës së shkrirjes së Esencës me Ekzistencën dhe mosarritjes;

3. Në nivelin **tingullor**: nëpërmjet përdorimit të **asonancës**: Venitur si antulja, **mbuluar** nga bora/, të hapësh e të mbyllësh sytë u mbyt/ duke theksuar nëpërmjet përdorimit të zanores së mbyllur “u” e y” humbjen e **esencës**, fjalës kyç që përmbledh ëndrrat, iluzionet dhe në tërësi transhendentalen; **përpyjekja heroike, fisnike, vigane/** ku theksimi i tingullit të mprehtë “i” jep vizualisht dhe tingëllisht idenë e thikës, simbol i përpyekjes dhe luftës; **konsonancën dhe aliteracionit: shumë e shkurtër jeta për t’i përmbushur premtimet/**, ku tingulli i “sh” krijon idenë e rrëshqitjes, ikjes së kohës; **Struktura e arkitektit, kështjellë ideale**; ku tingulli i “k” krijon pengesën mes ëndrrës dhe mosrealizimit, mospërputhjes së ekzistencën me esencën, etj.

4. Në nivel **sintaksor e morfologjik**: vërehet përdorimi i fjalive fthilluese

2 Robert Barthes, *Elementi di semiologia*, Torino, Einaudi, fq. 18.

3 Sipas Kirkegardit njeriu për të vendosur veten esenciale kalon në një proces transformimi të përbërë nga tri faza: **faza estetike** e dominuar nga pasionet dhe impulset emocionale, **faza etike**, kur njeriu i njeh dhe i pranon vetes rregullat e zgjedhjes që formon arsyeja dhe faza e tretë, **ajo fetare** (e besimit, përjetësisë) ku njeriu nuk kalon si rezultat i procesit të zgjedhjes, por si rezultat i një hopi besimi. Samuel Enoch Stumpf, *Historia e filozofisë*, vep. cit, fq. 448.

me lidhësen që ose fjalive përcaktore me përemrin lidhor që: ***E kuptuan që po ikën Nëntori;/ Bezdis plakun që i ka ngrirë dora;/ Në udhëtimin që e spërkati me lot e me lemza***; fjalitë ffilluese e përcaktore ndihmojnë në sqarimin e mendimit; janë më të pranueshme për prozën ose për poezinë klasike; ideja filozofike në një rast të tillë kërkon një fjali klasike mendimi, e jo fjalë të mëvetshme poetike; Struktura sintaksore e fjalive paraqitet: kallëzues+kryefjalë+përcaktor: ***Dezertojnë flokët e kokës;/ dridhen shpresat e lodhura/sillet melankolia syzezë/fluturon...koha tahmaqare***/duke vënë në qendër të vëmendjes kryefjalën e shprehur fillimisht me një emër konkret: ***flokët***, e më tej me emra abstraktë: ***shpresat/melankolia/koha***, të cilat të shkallëzuara pas njëra –tjetrës përbëjnë dhe rrafshet e kalimit nga faza konkrete e ndjesive në fazën e shpresave të etapës së dytë, mosrealizimi i të cilave prodhon ankthin apo ***Melankolinë*** për pamundësinë e arritjes së fazës finale të ***Kohës*** së përjetshme që përbën dhe qëllimin e rrugëtimit të njeriut. Është përdorur në rrafshin leksikor edhe një fjalë e huaj së cilës vështirë t'i gjendet e barasvlershmja në shqip: ***eulogji***, si tërësi uratash apo frazash lavdëruese të cilat përdoren në të gjitha besimet, si të krishtera ashtu dhe myslimane a orientale. Përzgjedhja e qëlluar e fjalës, e shoqëruar me mbiemrin kontrastues “gënjeshtare” thekson idenë e padobisë së çfarëdolloj përpjekje për të mbërritur Përjetësinë. Po kështu folja e huazuar me të cilën hapet poezia: ***dezertojnë (flokët)***, e përdorur në vend të ***bien***, synon t'i japë rënies një ngjyrim tradhtie, shtresim kuptimor ky i nënkuptuar nga folja “dezertoj”: koha ikën sikur e tradhton njeriun; përdorimi i fjalës së huaj dëshmon edhe ngulitjen e gjuhës së huaj në subkoshiençën e poetit, shpërthimet e të cilit ngurrojnë të gjejnë fjalët e hershme të shqipes së papërdorur në mërgim, si dhe ngërçin e Luzajt filozof për të shprehur mendimin abstrakt me terminologjinë e shqipes . Një tjetër veçanti është krahasimi i ***esencës*** me fjalën ***antulja***⁴, përdorimi i së cilës përmbys idenë e mësipërme të ngërçit gjuhësor, duke na e paraqitur huazimin të qëlluar dhe si pasurim të gjuhës: esenca është e pakapshme, dhe ideja e ëndrrës për ta gjetur venitet si Antulja që mbeti një vend mitik. Në këtë rast është gjetur një toponim i përdorur qëllimisht jo me shkronjë të madhe, por si emërtim luleje të rrallë që mbart përveç magjisë së mitit edhe aromën e lules.

Rëndësinë në sintagmën ***emër+mbiemër*** e merr emri që i paravendoset mbiemrit duke ruajtur rendin e zakonshëm të shqipes, si për të theksuar idetë thelb të boshtuara tek emri, cilado qofshin ngjyrimet e tyre të

4 Antulja (variant i emrit “Antilia”) - ishull legjendar i vendosur në Oqeanin Antlantik perëndimor. Ky ishull mitik njihet dhe si Ishulli i Shtatë Qyteteve dhe si Ishulli i Shën Brendanos. Legjendat e përmendin që herët por asnjëherë nuk u gjenden gjurmët e tij të vërteta. Marrë nga artikulli: “The Origin of the Name Antillia” i G. R. Crone në *The Geographical Journal*, Vëll. 91, No. 3 (Mar, 1938), fq. 260-262 .

prapavendosura: *shpresat e lodhura/melankolia syzezë/esenca atavike/koha tahmaqare/përpyekja heroike*, etj.

5. *Në nivel semantik-figurativ e logjik*, që ka të bëjë me figurat e kuptimit dhe të shprehjes vërehet përdorimi i dendur i metaforave foljore: *dezertojnë flokët/ ikën Nëntori/ dridhen shpresat/ vaniteti kërkon/ sillet melankolia/ esenca lodhi/ fluturon koha/ dorëzohet Ekzistenca/ Ekzistenca fik çirakun dhe bie për të fjetur/*, përbëjnë bazën e figuracionit mbi të cilën ngrihet poezia, si për të dëshmuar rrekjen e Iदेve kryesore (që i përkasin shtresës së ndjesive, apo më gjerë Esencës) për t'u konkretizuar nëpërmjet mjetit⁵ foljor, i cili vepron në një fushë konkrete (të Ekzistencës); kësisoj metaforat janë përpjekje për shkrirjen e Esencës (emërtim-ide) me Ekzistencën (folje-veprimi); metafora mbiemra: *shpresat e lodhura/ mermer të pabesë/ eulogjisë gënjeshtare/ melankolia syzezë/ mizë etuar/ i egër, i fortë realiteti/ koha tahmaqare/*, në të cilat sërish emrat përbëjnë rrafshin parësor, ndërsa mbiemrat mjetin që i kalon në një sferë kuptimore të dytë, e cila në të gjitha rastet të çon tek njeriu, duke vërtetuar përpjekjen për shkrirjen në një të Iदेve që bëjnë pjesë në Esencë, me **njeriun** e fazës Ekzistenciale.

Do të vazhdonim edhe me figurat e tjera si *krahasimet*: *Bjenë iluzionet aty në të mugur/ si fletë ulliri kur zhvishet i gjori/; Sillet për qark melankolia syzezë/Si mizë fluturake etuar në qilare; epitetet: Përpyekja heroike, fisnike, vigane/kështjellë ideale*, të përdorura për të lartuar përpjekjet (konkrete) për të arritur të paarritshmen, kështjellën e idealizuar (abstrakte).

6. *Në nivel kohor*, që ka të bëjë me kohët e foljeve në tekst: zgjedhja e kohëve të foljeve është shumë e qëlluar dhe shërben për të ilustruar idenë filozofike të kohës që kalon: në strofën e parë e të dytë autori për të paraqitur idenë, mendimin që e bën të vuaj, përdor kohën komentuese⁶, ose përshkruese, paraqitëse, *të tashmen*:

dezertojnë/ikën/dridhen/kërkon/sillet/bezdis/, ndërsa në strofën e tretë e të fundit, për të dëshmuar se të gjitha përpjekjet janë të kota për të arritur Pavdekësinë, për të mbajtur të mbërthyer kohën që ikën, përdor kohën e kryer të thjeshtë të foljeve: veprimi nuk ka më kthim pas: *lodhi/ mbaroi/u mbytyqe/jetoi/mbeti/kërkoi/spërkati*, ku ndërfiten disa folje në të tashmen, si përpëlitse të kohës para përmbylljes: *fluturon/ dorëzohet/fik/bie*.

7. *Në nivel topologjik-kulturor*, që ka të bëjë me marrëdhëniet dhe

5 I. Armstrong Richards, *La filosofia della retorica*, Milano, Feltrinelli, 1967, fq.92.

6 Sipas H. Weinrich, kohët foljore në një tekst ndahen në: Kokë komentuese (e tashme, e kryer, e ardhme), kohë rrëfyese të planit të parë (koha e kryer e thjeshtë), kohë sfondi (e pakryera) dhe koha e perspektivës në të ardhmen (lidhja e pakryer dhe e kryer e plotë); shiko: H. Weinrich, *Tempus*, Bologna, il Mulino, 1978, fq. 37-73.

kundërshtitë hapësinore me anë të të cilave paraqitet bota, sipas teorisë së Lotmanit⁷: hapësirë e brendshme (IN) /hapësirë e jashtme (ES), kemi:

shpresat e lodhura duke u strukur (IN)/*sillet përçark melankolia syzezë* (ES); *Esenca...zhdukur si antulja...*(ES) *mbuluar nga bora* (IN)/*fluturon koha* (ES); *Ekzistenca ...bie për të fjetur* (IN)/*Atë që kërkoi, kurrë s'e pati gjetur në udhëtimin* (ES); ku Esenca me dyzimin e saj (IN+ES) humbet dhe Ekzistenca konkrete përfundon e mbyllura (IN), në një hapësirë të brendshme, të kyçur brenda qenies, ndërsa koha e nënkuptuar si përjetësi mbetet e jashtme (ES), e pashkrirë me qenien si esencë dhe ekzistencë. Konceptimi i kohës si e jashtme (ES) është dhe konkluzioni i parealizimit, mosarritjes së Pavdekësisë së qenies (Esencë (IN+AS) +Ekzistencë(IN)).

8. *Në nivel simbolik-arketipor/apo psikoanalitik*⁸, bazuar në teorinë jungiane (si dhe studiuesve të letërsisë dhe antropologjisë kulturore) mbi simbolet dhe arketipat, ose shfaqet e pavetëdijshme të eksperiencave të përbashkëta njerëzore, do të vërenim: praninë e simboleve dhe arketipave të sferës së poshtme: ***bimësisë***: *gjetheve të rëna*, ***tokës***, parë në aspektin negativ, të mbylljes, të kalbjes, mbarimit. Po kështu edhe në strofën e dytë vazhdohet me objekte toke: *mermer*, si dhe me *mizën si simbol i fluturimit* të kotë, lodhës së pashpresë, që nuk arrin lartësitë e duhura; vetë Korbi është një simbol i fajit të ekzistencës, si dhe i vdekjes; *bora* që mbulon esencën është simbol i pastërtisë, gjithashtu koha *mbytet në valët e detit*, duke simbolizuar rrjedhën e kohës, që nuk ndalet dhe nuk mund të përmbahet, të fiksohet.

Edhe simboli antropologjik e psikoanalitik i vdekjes, i mbarimit, si fikje e rënie në gjumë, e ngulitur në shprehjet: ***u fik, u shua, ra***, në poezi i vishet Ekzistencës: *Dorëzohet më në fund Ekzistenca,/fik çirakun dhe bje për të fjetur./*

9. *Në nivel tematik-ideologjik e komunikativ*, ku shkrihen dhe nivelet e mësipërme, ku gjejnë shprehje temat e ndërmarra për trajtim dhe shtrirja e tyre hapësinore, komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm. Në poezi vërehet një shtresim i trefishtë ideologjik e komunikativ të vizionit filozofik të poetit: ***shtresimi i parë*** (strofa e parë) ndjesor, konkret - ***rënia e flokëve/fletëve të ullirit***- (plakja/kalbja)- baraspeshuar me shkallën e parë të ekzistencës në filozofinë Kirkegardiane të Rënies: ***fazën estetike***; ku rënia është natyrale dhe e pashmangshme; ***shtresimi i dytë*** (strofa e dytë) etike, ku poeti nuk beson se njeriu mund të kalojë për shkak të vanitetit të tij, i cili ia vjedh, ia përvetëson ose ia rrëzon shkallën e dytë ngjitëse, atë të Moralit, Etikës, Fesë; kjo fazë e dështimit etik, e sipërmarrjes së arsyes,

7 Jurij Lotman, *La struttura del testo poetico*, Milano, Mursia, 1976, fq. 261-273.

8 Për këtë çështje mund të konsultohen veprat e Jungut dhe të studjuesve të tjerë të letërsisë dhe antropologjisë kulturore si Durand, Levi-Strauss, të cilët kanë parashtruar një univers imagjinar dhe letrar me një tërësi simbolesh, arketipesh e mitesh.

prodhon melankolinë dhe ngrin njeriun, e ftoh ndjeshmërinë e tij, përgatit rënien përfundimtare **të fazës së tretë** (strofa e tretë) në të cilën esenca mbetet e pakapshme si antulja, si ëndërr dhe dëshirë e bardhë (mbuluar nga bora), tek e cila Ekzistenca nuk arrin dot, ndaj dorëzohet. Rënia është e pashmangshme, ndërsa koha ikën duke mos arritur përputhjen me njeriun në Përjetësi.

Poezia **Korbi** është një shembull gërshetimi i mendimit abstrakt me ligjërimin poetik. Përmes kësaj poezie filozofi Luzaj ka arritur të shprehë ankthin e vdekjes dhe kohës që ikën përmes gjuhës poetike. Mendimi abstrakt në poezi ka arritur të ndërthuren organikisht në ligjërimin poetik, edhe pse ka raste kur mbitheksimi i terminologjisë filozofike dhe sentencave didaktiko –moralizuese e lodhin vargun.

Si përfundim vlen të theksohet se Luzaj mbetet një nga shembuj e pakët të lëvrimin gjerësisht të filozofisë poetike në gjuhën shqipe, dhe do t'i shkonte për shtat përcaktimi i Sidneit që poeti është thjesht filozof popullor.

Bibliografia e veprave të Luzajt

Luzaj Isuf, *Rrëfimet*, Shtypshkronja Dhori Koti, Korçë, 1937.

Luzaj Isuf, *Los rijos bajan rojos*, Ultimar, Buenos Aires, 1954.

Luzaj Isuf, *Gloria e çmendjes*, Shtëpia Botuese Alta, Tiranë, 1995.

Luzaj Isuf, *Ekzistenca dhe boshësia*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë, 1996.

Luzaj Isuf, *Sëmundjet e shekullit tonë*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 1999.

Luzaj Isuf, *Lamtumira e yjeve*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 2001.

Luzaj Isuf, *Topografi labçe*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 2001.

Luzaj Isuf, *Përtej së mirës dhe së ligës*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 2003.

Luzaj Isuf, *Rindërtimi i fuqive shpirtërore*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 2005.

Luzaj Isuf, *Filozofia e bukurisë*, SH.B. Ombra GVG, Tiranë, 2009.

Luzaj Isuf, Fragmenti nga dorëshkrimi “Cikënditë e fundit të kandilit” në revistën “Përpjekja”, nr. 3, 1995.

Luzaj Isuf, Fragmenti nga dorëshkrimi “Kujdesjet e bletës”, në revistën “Mehr Licht”, nr. 17.